

**MBI NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË DHE NË TREGUN VALUTOR
GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2010**

1. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2010

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë¹).

DATA	R/REPO njëjavore me çmim variabël	R/REPO mujore	R/REPO tremujore
01.07.2010	15,060.00		3,000.00
08.07.2010	13,150.00		
15.07.2010	18,500.00		
22.07.2010	23,000.00		
29.07.2010	19,390.00		
05.08.2010	17,210.00		
12.08.2010	19,000.00		
19.08.2010	19,120.00		
26.08.2010	17,500.00		
02.09.2010	18,500.00		
10.09.2010	17,600.00		
16.09.2010	19,200.00	4,000.00	
23.09.2010	15,050.00	3,000.00	

shtator në vlerën 4 miliardë lekë e 3 miliardë lekë.

1.1. Operacionet e tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2010 përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektimin e likuiditetit.

Për të injektuar likuiditetin, Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor mesatarisht 17.86 miliardë lekë¹ në javë si dhe instrumentet rregulluese me maturim më të gjatë se një javë. Marrëveshja e anasjelltë tremujore është përdorur në muajin korrik në vlerën 3.0 miliardë lekë, ndërsa marrëveshja e anasjelltë e riblerjes me maturim njëmuajor u përdor në dy raste në muajin

¹ Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.


1.2 Përdorimi i instrumenteve mbështetëse


Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2010, depozita njëditore u përdor në 26 raste, mesatarisht 0.48 miliardë lekë, gati 0.15 miliardë lekë më shumë se tremujorin e kaluar. Edhe gjatë këtij tremujori, përdorimi i depozitës njëditore ishte më intensiv gjatë ditëve të fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar.

Gjatë tremujorit të tretë, instrumenti i kredisë njëditore u përdor në 18 raste, mesatarisht 0.89 miliardë lekë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmbledhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për nëntë muajt e parë të vitit 2010.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë vitit 2010 (me çmim blerjeje).





2. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm valutor gjatë tremujorit të tretë të vitit 2010

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në tregun valutor, duke u kthyer në kahun e blerjes së valutës për herë të parë që nga muaji gusht 2008. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë kanë synuar fillimisht shmangien e çrregullimeve të tregut të brendshëm valutor dhe më pas rritjen e rezervës valutore. Gjatë tremujorit të tretë, Banka e Shqipërisë ka shitur 1,597.63 milionë lekë.

2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë kësaj periudhe, kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Blerjet nga Ministria e Financave gjatë kësaj periudhe qenë 1,371.73 milionë lekë, ndërsa shitjet 1,362.00 milionë lekë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 26.02 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - IBRD).

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE	1,371.73	1,362.00
TË TJERA (IDA, IBRD)	26.02	